

VENDIM
Nr. 214, datë 17.4.2019

PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR. 187, DATË 8.3.2017, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE, NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, GJYKATËN E LARTË, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr.152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr.9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura të krijuara me ligj", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, "Për buxhetin e vitit 2019", me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 187, datë 8.3.2017, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shitesat, me këtë përmbajtje:

a) në fund të pikës 1/1 shtohen emërtesat "Këshilli i Lartë Gjyqësor" dhe "Këshilli i Lartë i Prokurorisë".

b) në pikën 5, pas fjalëve "... Stenograf, regjistruar audio në Kryeministri ..." shtohen fjalët "... dhe "Specialist redaktor në Kuvendin e Shqipërisë"..."

c) pas pikës 7/1 shtohet pika 7/2, me këtë përmbajtje:

"7/2. Nivelet e pagave për funksionarët e kabineteve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë janë sipas lidhjes nr.4/2/a, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë janë sipas lidhjes nr.4/2/b, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij."

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, për vitin 2019, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion dhe të fillojnë nga:

a) momenti i transferimit apo emërimit të funksionarëve dhe nëpunësve, për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë;

b) momenti i hyrjes në fuqi të këtij vendimi, për Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

Lidhja nr. 4/2/a

**Nivelet e pagave për funksionarët e kabineteve në Këshillin e Lartë Gjyqësor
dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë**

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Drejtor i kabinetit të kryetarit të KLGJ-së. Drejtor i kabinetit të kryetarit të KLP-së.	I-a	1
Këshilltar në kabinetin e kryetarit të KLGJ-së.	Barazohet në pagë me zëvendësministrin	
Këshilltar në kabinetin e kryetarit të KLP-së.	I-b	
Ndihmës në kabinetin e kryetarit të KLP-së.	III-a	1
Sekretar i kryetarit të KLGJ-së. Sekretar i kryetarit të KLP-së.	Barazohet në pagë me sekretarin e Kryeministrit	

Lidhja nr. 4/2/b

**Kategoritë e pagave të pozicioneve të punës së nëpunësve në Këshillin e Lartë Gjyqësor
dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë**

POZICIONI	KATEGORIA	KRITERI MINIMAL I DIPLOMËS SË SHKOLLËS SË LARTË PËR EFEKT TË PRANIMIT NË POZICIONIN PËRKATËS TË PUNËS PAGA E GRUPIT
Sekretar i Përgjithshëm.	I-a	1
Drejtor Departamenti.	I-b	1
Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme. Drejtor Njësie. Nëpunës në njësinë përgjegjëse për vlerësimin e profesionalizimit dhe etikës së gjyqatrëve për vettingun në KLGJ.	II-a	1
Këshilltar i komisioneve të përhershme në KLGJ. Këshilltar në departamentin/njësinë përgjegjëse për shërbimet ligjore në KLP. Drejtor Drejtorie.	II-b	1
Përgjegjës/Shef Sektori.	III-a III-a/1	1
Specialist.	III-b	1 ose 2
Specialist.	IV-a	1 ose 2 ose 3

	IV-b	
--	------	--